




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac – Municipality of Rahovec

KRYETARI I KOMUNËS
Presednik Opštine – Municipal Mayor


**LISTA E VENDIMEVE TË MARRA NGA KRYETARI I KOMUNËS SË RAHOVECIT,
Z. SMAJL LATIFI**

NGA DATA 14.07.2025 DERI MË 18.07.2025

NR.	EMRI I VENDIMIT	NR. I PROTOKOLLIT
1.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).	NRP-02-6310-2025
2.	Vendim për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave: "Asfaltimi i rrugës Rahovec-Drenoc-Senoc-Pastasel-Polluzhë".	NRP-02-6317-2025
3.	Vendim me të cilin u lejohet të gjithë mergimtarëve hyrja pa pagesë në oborrin e komunës dhe në oborrin e ShFMU "Bekim Sylka" në Rahovec.	NRP-02-6318-2025
4.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).	NRP-02-6320-2025
5.	Vendim për ndërprerjen e kontratës me titull: "Rregullimi i kanaleve të kullimit të tokave bujqësore-Lot 4-Ndërtimi i urës dhe kanalit të kullimit në Çifllak".	NRP-02-6327-2025
6.	Vendim për miratimin e kërkesës për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).	NRP-02-6328-2025
7.	Vendim për miratim i kërkesës për vazhdim strehimi të përkohëshëm.	NRP-02-6330-2025
8.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës "Instalimi i ngrohjeve qendrore të reja,riparimi dhe mirëmbajtja e tyre-Ritenderim".	NRP-02-6331-2025
9.	Vendim për caktimin e menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës "Ndërtimi i kompleksit sportiv në zonën turistike në Rahovec-Faza e tretë-Ritenderim".	NRP-02-6337-2025



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] nga Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-0025227/25, e dt. 10.07.2025 për ndihmë financiare prej 500.00€ (pesëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Znj. [redacted] nga Rahoveci me datë 10.07.2025 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehoni (lindje) pasi që me datë 25.06.2025 ka lindur **Djal** në QKMF “Dr. Fahredin Hoti” në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për [redacted] dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- **Znj.** [redacted] nga Rahoveci,
- **Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,**
- **Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe**
- **Arkivi.**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac/Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6317 Nr. i faq/Br.str/No.pg 134

Data/Datum/Date 14 / 07 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në bazë të nenit 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040, nenit 59 të Ligjit Nr.04/L-042 të Prokurimit Publik, nenit 37 të Ligjit Nr.05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Prokurimin Publik, nenit 69 dhe 92 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 të datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e komisionit për vlerësimin e ofertave

1. **Caktohet** komisioni për vlerësimin e ofertave për projektin: “Asfaltimi i rrugës Rahovec – Drenoc – Senoc – Pastaselë – Polluzhë”, me Nr. prokurimi: 623-25-1580-5-1-1, dhe Nr. të brendshëm: 623-25-026-5-1-1 të datës: 14.7.2025, në këtë përbërje:
 - 1.1. Jetmir Ukaj, kryesues,
 - 1.2. Sokol Thaqi, anëtar,
 - 1.3. Jeton Krasniqi, anëtar,
 - 1.4. Nazlishahe Canziba, anëtare,
 - 1.5. Faik Thaqi, anëtar.
2. Komisioni ka për detyrë të bëjë vlerësimin e ofertave për projektin “Asfaltimi i rrugës Rahovec – Drenoc – Senoc – Pastaselë – Polluzhë”, me Nr. prokurimi: 623-25-1580-5-1-1, dhe Nr. të brendshëm: 623-25-026-5-1-1 të datës: 14.7.2025.
3. Obligohet komisioni që këto punë ti kryej duke u bazuar në legjislacionin në fuqi.
4. Komisioni do të fillojë punën menjëherë pas nënshkrimit të këtij vendimi dhe punët duhet të përfundojnë në afat jo më shumë se 30 ditë nga hapja e ofertave.
5. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.


Vendimi u dërgohet:

- Anëtarëve të komisionit,
- Zyrës së Prokurimit, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 44 dhe nenit 49 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 20/2016”) si dhe nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. Me të cilin u lejonet të gjithë mërgimtarëve hyrja pa pagesë në oborrin e komunës dhe në oborrin e ShFMU “Bekim Sylka” në Rahovec me automjete private që janë me tabela të huaja dhe atyre të marra me qira (rent a car).
2. Hyrja e mërgimtarëve pa pagesë në oborrin e komunës dhe në oborrin e ShFMU “Bekim Sylka” në Rahovec me tabela të huaja dhe atyre të marra me qira (rent a car), lejonet nga data **15 korrik 2025** deri me datë **15 gusht 2025**.
3. Punonjësve të administratës dhe drejtorëve të drejtorive në Komunën e Rahovecit, u ndalohet hyrja me automjete private në oborrin e komunës gjatë kësaj periudhe të cekur në pikën 2 të këtij vendimi.
4. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdesen Drejtoria për Administratë dhe Drejtoria për Arsim.
5. Mosrespektimi i këtij vendimi do të konsiderohet shkelje e kodit të mirësjelljes dhe do të merren masa konform ligjeve, si dhe akteve nënligjore të aplikueshme në Republikën e Kosovës.
6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Vendimi u dërgohet:

- Drejtorisë për Administratë,
- Drejtorisë për Arsim, dhe
- Arkivit.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo

Komuna e Rahovecit

Opština Orahovac / Municipality Rahovec

Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Posta Nr. 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No. 6320 Nr. i faq./Brshr./No. pg. 134

Data/Datum/Date 15 / 07 / 25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa [redacted] nga Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-0025823/25, e dt. 14.07.2025 për ndihmë financiare prej 500.00€ (pesëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Znj. [redacted] nga Rahoveci me datë 14.07.2025 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehoni (lindje) pasi që me datë 12.07.2025 ka lindur **Djal** në QKMF "Dr. Fahredin Hoti" në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për znj. [redacted] si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- Znj. [redacted] nga Rahoveci,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.



Kryetari i Komunës



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6327 Nr. i faq/Br.str/No.pg 135

Data/Datum/Date 16/07/25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të dispozitave të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenit 72 të Rregullores Nr. 002/2024 për plotësimin dhe ndryshimin e Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 74 dhe 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 i datës 29.03.2017, rekomandimit dhe kërkesës me Nr. Prot. 2327 të datës 16.7.2025 të Menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtëpërdrejtë të menaxherit të kontratës me titull: “Rregullimi i kanaleve të kullimit të tokave bujqësore; Lot 4 – Ndërtimi i urës dhe kanalit të kullimit në Çifllak” me Nr. të prokurimit 623-21-2485-5-1-1/C301, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

**Për ndërprerjen e kontratës me titull “Rregullimi i kanaleve të kullimit të tokave bujqësore;
Lot 4 – Ndërtimi i urës dhe kanalit të kullimit në Çifllak”**

1. **Miratohet** kërkesa e menaxherit të projektit dhe mbikëqyrësit të drejtëpërdrejtë të menaxherit të kontratës për ndërprerjen e kontratës me titull “Rregullimi i kanaleve të kullimit të tokave bujqësore; Lot 4 – Ndërtimi i urës dhe kanalit të kullimit në Çifllak” me Nr. të prokurimit 623-21-2485-5-1-1/C301.
2. Ndërprerja e kontratës sipas pikës 1 të këtij vendimi bëhet për shkak të mos vazhdimit të punimeve nga ana e operatorit ekonomik.
3. Obligohet Zyra e Prokurimit që të ndërmerr të gjitha veprimet e nevojshme konform dispozitave ligjore në fuqi për ndërprerjen e kontratës sipas pikës 1 të këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Komuna e Rahovecit (në vazhdim “autoriteti kontraktues”) në njërën anë dhe Grupi i Operatorëve Ekonomik “Plural” SH.P.K.; “Arbor Group” SH.P.K.; “Pro & Co Group” SH.P.K. me seli në Prishtinë (në vazhdim “kontraktuesi”) në anën tjetër kanë nënshkruar kontratën me titull “Rregullimi i kanaleve të kullimit të tokave bujqësore; Lot 4 – Ndërtimi i urës dhe kanalit të kullimit në Çifllak” me Nr. të prokurimit 623-21-2485-5-1-1/C301 me Nr. Prot. 4031 të datës 25.8.2021.

Pas nënshkrimit të kësaj kontrate, operatori ekonomik ka fillur punët në terren me qëllim të rregullimit të ndërtimit të urës dhe kanalit të kullimit në Çifllak, në bazë të planit të punës dhe planit dinamik të punës të aprovuar nga ana e operatorit ekonomik dhe menaxherit të kontratës dhe atë vetëm deri para datës 14 tetor 2022 kur është kryer punimi i fundit në teren nga operatori ekonomik.

Duke verifikuar punët në teren nga Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtëpërdrejtë i menaxherit të kontratës, me datë 14 tetor 2022 ku i pranishëm ishte edhe punëkryesi janë vërejtur gabime në kryerjen e punëve në këtë projekt, ku pastaj përmes emailit janë listuar gabimet në punimin e këtij kanali, gjë që nuk ato punime nuk ishin në bazë të specifikave të parapara në kontratë.

Provë: Emaili i datës 14 tetor 2022.

Poashtu me datë 24 korrik 2024 Menaxheri i kontratës përmes emailit ka kërkuar nga Operatori Ekonomik (punëkryesi) që të del në teren dhe të vazhdoj punët për përfundimin e projektit të lartpërmendur, por që e njëjta kërkesë nuk është marrë parasysh nga ana e Operatorit Ekonomik dhe i njëjti nuk ka vazhduar punët e parapara me planin dinamik.

Provë: Emaili i datës 24 korrik 2024.

Edhe përkundër faktit se kushtet atmosferike kanë qenë të përshtatshme për punë pas kësaj date, operatori ekonomik (punëkryesi) gjatë kësaj periudhe nuk e ka respektuar planin dinamik dhe planin e menaxhimit të kontratës të miratuar nga Menaxheri i kontratës dhe punëkryesi, edhe përkundër faktit se përmes telefonit i është kërkuar në vazhdimësi që të vazhdojë punimet për përfundimin e këtij projekti, pasi që është me rëndësi për fermerët e kësaj ane.

Pas kësaj me datë 18 prill 2025, mbikëqyrësi i drejtëpërdrejtë i menaxherit të kontratës i është drejtuar përmes emailit me kërkesë për vazhdimin e punimeve për përfundimin e këtij projekti e që do të rezultonte edhe me përfundimin e kontratës, në të kundërtën do të inicohet procedura e ndërprerjes (shkëputjes) së kontratës për shkak të mos përmbushjes së kontratës nga ana e operatorit ekonomik, por nga ana e punëkryesit nuk ka pasur fare përgjigje.

Provë: Emaili i datës 18 prill 2025.

Tutje me datë 8 korrik 2025, mbikëqyrësi i drejtëpërdrejtë i menaxherit të kontratës së bashku me menaxherin e kontratës i janë drejtuar me email operatorit ekonomik (punëkryesit) kanë shprehur pakënaqësinë lidhur me mos vazhdimin e punimeve dhe ngecjen e tyre në tërësi në përfundimin e këtij projekti edhe përkundër faktit se gjatë bisedave telefonike është premtuar vazhdimi i punimeve nga ana e punëkryesit.

Provë: Emaili i datës 8 korrik 2025.

Pas kërkesave të vazhdueshme nga menaxheri i kontratës në drejtim të operatorit ekonomik për vazhdimin e punimeve për përmbushjen e kontratës të cekur në nenin 1 të këtij vendimi, menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtëpërdrejtë i menaxherit të kontratës ka parashtruar rekomandim dhe kërkesë tek Zyrtari Kryesor Administrative me Nr. Prot. 2327 të datës 16.7.2025 me të cilën ka kërkuar ndërprerjen (shkëputjen) e kontratës me titull “Rregullimi i kanaleve të kullimit të tokave bujqësore; Lot 4 – Ndërtimi i urës dhe kanalit të kullimit në Çifllak” me Nr. të prokurimit 623-21-2485-5-1-1/C301 me Nr. Prot. 4031 të datës 25.8.2021.

Andaj duke u bazuar në rekomandimin dhe kërkesën me Nr. Prot. 2372 të datës 16.7.2025 të Menaxherit të kontratës dhe mbikëqyrësit të drejtëpërdrejtë të menaxherit të kontratës si dhe duke u bazuar në nenin 36 paragrafi 36.1 dhe 36.2 shkronja b), lidhur me nenin 37 të Kontratës me Nr. Prot. 4031 të datës 25.8.2021 me titull “Rregullimi i kanaleve të kullimit të tokave bujqësore; Lot 4 – Ndërtimi i urës dhe kanalit të kullimit në Çifllak” me Nr. të prokurimit 623-21-2485-5-1-1/C301 është konstatuar se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore për ndërprerjen (shkëputjen) e kësaj kontrate.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshilla Juridike: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afat prej 10 ditësh, nga dita e pranimi të tij, pranë Autoritetit Kontraktues.

Me vendim të njoftohen:

- *Grupi i OP “Plural” SH.P.K.; “Arbor Group” SH.P.K.; “Pro & Co Group” SH.P.K.,*
- *Zyra e Prokurimi,*
- *Menaxheri i Projektit, dhe*
- *Arkivi.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac / Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës Nr.03/L-040 (Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008), nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr.1005 i datës 29.03.2017 dhe nenit 4 paragrafi 4 dhe nenit 21 paragrafi 2 pika 2.4 të Rregullores për Kushtet, Kriteret dhe Procedurat e Ndarjes së Subvencioneve me Nr.1427 të datës 28.04.2017, Kryetari i Komunës, merr këtë:

V E N D I M

1. **MIRATOHET** kërkesa e [redacted] nga Rahoveci me Nr. Protokolit 06-553/01-0026083/25, e dt. 16.07.2025 për ndihmë financiare prej 500.00€ (pesëqind euro) për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë (lindjes).
2. Mjetet sigurohen nga kodi i subvencioneve të Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
3. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Buxhet dhe Financa.
4. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Znj [redacted] nga Rahoveci me datë 16.07.2025 ka parashtruar kërkesë për ndihmë financiare për lehonitë (lindje) pasi që me datë 13.07.2025 ka lindur **Djal** në QKMF “Dr. Fahredin Hoti” në Rahovec.

Marrë parasysh se, e lartpërmendura nuk është në marrëdhënie pune të vazhdueshme dhe me këtë rast e njëjta pas shpenzimeve të lindjes e ka të vështirë përballimin e shpenzimeve të blerjes së gjërave elementare për fëmijën, është e domosdoshme ndihma financiare për mbulimin e shpenzimeve të lehonisë për znj [redacted] si dhe ndihma për sigurimin e gjërave elementare për foshnjën.

Andaj, duke marrë parasysh atë që u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi

Me vendim të njoftohen:

- Znj. [redacted], nga Rahoveci,
- Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,
- Drejtoria për Buxhet dhe Financa, dhe
- Arkivi.





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KRYETARI I KOMUNES / KRYETARIT I KRYETARIT TE KOMUNES

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 6330 Nr. i faq./Br.str./No.pg 135
Data/Datum/Date 16 / 07 / 25
RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13, nenit 17 pika k) dhe nenit 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Kosovës ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 28/2008"), nenit 12 pika 12.1, 12.4 dhe 12.5 të Ligjit Nr. 02/L-17 për Shërbimet Sociale dhe Familjare dhe nenit 57 paragrafi 1 pika 1.11, nenit 74 dhe nenit 92 paragrafi 1 dhe 4 të Statutit të Komunës së Rahovecit Nr. 1005 të datës 29.03.2017, dhe kërkesës së znj. Pranvera Shala, me nr. prot. 2297 të datës 08.07.2025, Kryetari i Komunës merr këtë:

V E N D I M

1. **Miratohet** kërkesa e znj. Pranvera Shala, me vendbanim në Rahovec, e cila jeton me bashkëshortin dhe e dy fëmijë të mitur (një vajzë dhe një djalë), për strehim të përkohshëm emergjent (vazhdimi i strehimit) si rast në nevojë sociale në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, respektivisht prej datës 01.07.2025 deri më 31.12.2025, tek pronari Halim Hoxha në Rahovec të përfaqësuar nga Bashkim Hoxha.
2. **Pagesa** në emër të qirasë do të jetë në shumën prej **150.00€ (njëqind e pesëdhjetë euro)** për çdo muaj.
3. **Autorizohet** drejtori i Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesjes Sociale në Komunën e Rahovecit që sipas autorizimit ligjor të lidh marrëveshje për strehim të përkohshëm të familjes në nevojë sociale.
4. Përfitues nga pika 1 të këtij vendimi është zonja Pranvera Shala.
5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale.
6. Vendimi hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

A r s y e t i m

Drejtoria për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale, pas pranimit të kërkesës nga pala, ka konstatuar se bëhet fjalë për familjen si kategori sociale me dy fëmijë të mitur, e që nuk kanë ku të strehohen, jetojnë me qera, ku të vetmin burim të të ardhurave i ka nga Skema e Ndihmave Sociale, shumë e cila është e pamjaftueshme për ti mbuluar të gjitha shpenzimet.

Mjetet për pagesë do të sigurohen nga kodi i shërbimeve sociale përmes DSHMS-së, duke qenë se bëhet fjalë për rastin emergjent të strehimit të familjes, vendimi nuk është bazuar në procedurat ligjore që rregullojnë çështjet e prokurimit në Kosovë.

Andaj, nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi u dërgohet:

- **Znj. Pranvera Shala,**
- **Drejtorisë për Shëndetësi dhe Përkujdesje Sociale,**
- **Arkivit.**





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine **Municipal Mayor**



REPUBLIKA E KOSOVES/REPUBLIKA KOSOVO/REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA ORAHOVAC/MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS/KABINET PREDSEDIKA OPŠTINE/MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6331 Nr. i faq./Br.str./No.pg 136

Data/Datum/Date 17/07/25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: **“Instalimi i ngrohjeve qendrore të reja, riparimi dhe mirëmbajtja e tyre – Ritenderim”**, me numër të kontratës: **623-25-4844-2-2-1/C684**, si në vijim:
 - 1.1. “P.M.N.” Sh.p.k. me adresë në Prishtinë, të cilën e përfaqëson z. Zenun Tolaj, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
 - 1.2. Afrim Limani, drejtor i Drejtorisë për Financa dhe Buxhet, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.
2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit të Menaxherit të Kontratës.
3. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
 - 3.1. Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë;
 - 3.2. Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë; dhe
 - 3.3. Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.
4. Funksionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë:
 - 4.1. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i kontratës

brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";

- 4.2. Menaxheri i kontratës, duhet të lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;
- 4.3. Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërblertjen;
- 4.4. Pas pranimit të urdhërblertjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërblertjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;
- 4.5. Të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- 4.6. Të sigurojë që Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- 4.7. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- 4.8. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;
- 4.9. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
- 4.10. Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulin për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;
- 4.11. Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- 4.12. Të sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;
- 4.13. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;
- 4.14. Të japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe
- 4.15. Të dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.

5. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:

- 5.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe
- 5.2. Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- *Menaxheri i kontratës,*
- *Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,*
- *Spektori i Prokurimit, dhe*
- *Arkivi.*





Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Komuna e Rahovecit
Opština Orahovac/Municipality Rahovec
Kryetari i Komunës – Presednik Opštine – Municipal Mayor



Njësia Nr./Br./No 02(Kabineti i Kryetarit të Komunës)

Nr./Br./No 6337 Nr. i faq./Br.str/No.pg 136

Data/Datum/Date 18/07/25

RAHOVEC / ORAHOVAC

Në mbështetje të nenit 13 dhe nenit 58 të Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale të Kosovës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 28/2008”), nenit 81 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-92, nenit 70, paragrafi 70.18, i Rregullores Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik të datës 20.10.2022, nenit 74 dhe nenit 92, paragrafi 1 dhe 4, të Statutit të Komunës së Rahovecit, Nr.1005, i datës 29.3.2017 dhe propozimit të Përgjegjësit të Njesisë Kërkuese dhe Zyrtarit Përgjegjës të Prokurimit, kryetari i Komunës së Rahovecit, merr këtë:

V E N D I M

Për caktimin e menaxherit të kontratës dhe të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës

1. Caktohet menaxheri i kontratës dhe mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës me titull: “**Ndërtimi i kompleksit sportiv në zonën turistike në Rahovec – Faza e tretë – Ritenderim**”, me numër të kontratës: **623-25-4622-5-2-1/C685**, si në vijim:

1.1. “P.M.N.” Sh.p.k. me adresë në Prishtinë, të cilën e përfaqëson z. Zenun Tolaj, **CAKTOHET** menaxher i Kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

1.2. Afrim Dina, drejtor i Drejtorisë për Kulturë, Rini dhe Sport, **CAKTOHET** mbikëqyrës i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës, sipas pikës 1 (një) të këtij vendimi.

2. Menaxheri i kontratës dhe Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë i Menaxherit të Kontratës, obligohen që të bëjnë administrimin dhe menaxhimin e implementimit të kontratës, në pajtim me Ligjin e Prokurimit Publik, Rregulloren 01/2022 për Prokurimin Publik, Manualin për Përdorim të Modullit për Menaxhimin të Kontratës, si dhe të rregullave të tjera, të cilat kanë të bëjnë me menaxhimin e kontratës. Pas nënshkrimit të kontratës dhe të emërimit të Menaxherit të kontratës (MK), të gjitha përgjegjësitë, përveç kompetencës për të ndryshuar apo ndërprerë Kontratën, barten nga zyra e prokurimit të Menaxherit të Kontratës.
3. Përgjegjësitë e Menaxherit të Projektit/Kontratës janë:
 - 3.1. Menaxheri i kontratës do të menaxhojë obligimet dhe detyrat e Autoritetit Kontraktues të specifikuar në kontratë;
 - 3.2. Menaxheri i kontratës do të sigurojë se Operatori ekonomik kryen kontratën në përputhje me termat dhe kushtet e specifikuar në kontratë; dhe
 - 3.3. Menaxheri i kontratës do të bëjë vlerësimin e performancës së kontraktuesve për kontratat nën menaxhimin e tij.
4. Funksionet e Menaxherit të Projektit/Kontratës, janë:
 - 4.1. Në pajtim me Kapitullin V të Rregullores 01/2022 për Prokurimin Publik, pas pranimit të Njoftimit për emërim si menaxher i kontratës, menaxheri i Kontratës, duhet të kyçet në Sistemin e Prokurimit Elektronik dhe duhet të fillojë me fazat e menaxhimit të Kontratës nëpërmjet funksioneve për menaxhim të kontratës. Si fazë e parë, Menaxheri i kontratës

brenda afatit, duhet të krijojë Planin për Menaxhim të kontratës, duke përdorur funksionin "Fillimi / mobilizimi i kontratës";

- 4.2. Menaxheri i kontratës, duhet të lexojë kushtet e kontratës dhe të përgatisë Planin e Menaxhimit të kontratës (PMK), i cili duhet të bie dakord me Operatorin Ekonomik;
- 4.3. Të dorëzojë Planin e aprovuar të Menaxhimit të Kontratës, kërkesën (fletëporosinë) dhe Zotimin e mjeteve në Zyrë të Prokurimit, në mënyrë që zyra e prokurimit të nxjerrë urdhërbljerjen;
- 4.4. Pas pranimit të urdhërbljerjes nga zyra e prokurimit, menaxheri i kontratës duhet të vendosë të dhënat në platformën elektronike, të ngarkojë në platformën elektronike urdhërbljerjen dhe ta përcjellë përmes platformës tek OE-ja, nga e cila datë fillon numërimi i afatit kohor për liferim;
- 4.5. Të sigurojë që Operatori Ekonomik i përmbush të gjitha obligimet e performancës, apo dërgesës në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- 4.6. Të sigurojë që Operatori Ekonomik e dorëzon tërë dokumentacionin e kërkuar, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- 4.7. Të sigurojë që Autoriteti Kontraktues i përmbush të gjitha pagesat dhe obligimet e tjera, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- 4.8. Të sigurojë se ka kontroll adekuat të kostove, të cilësisë, dhe të kohës aty ku është e përshtatshme;
- 4.9. Të sigurojë që të gjitha obligimet janë kompletuar para mbylljes së dosjes së kontratës;
- 4.10. Të sigurojë që të gjithë regjistrat e menaxhimit të kontratës të përgatiten, të mbahen dhe të arkivohen në modulën për menaxhim të kontratës, në sistem të prokurimit elektronik;
- 4.11. Të nxjerrë variacione apo urdhra për ndryshim, nëse kërkohet, në përputhje me termat dhe kushtet e kontratës;
- 4.12. T'i sigurojë detaje të plota të një ndryshimi të kërkuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit dhe ta marrë miratimin;
- 4.13. Të menaxhojë dorëzimet e procedurave të pranimit të punëve, të mallrave dhe të shërbimeve;
- 4.14. T'i japë detaje të plota për ndonjë ndërprerje të propozuar të kontratës, Departamentit të Prokurimit; dhe
- 4.15. T'i dorëzojë raportet mbi progresin ose kompletimin e një kontrate, siç kërkohet nga Departamenti i Prokurimit, ose nga ZKA-ja.

5. Përgjegjësitë e Mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të menaxherit të kontratës, janë:

- 5.1. Monitorimi i drejtpërdrejtë i menaxherit të kontratës; dhe
- 5.2. Rishikimi, aprovimi dhe procesimi i vlerësimit të performancës së kontraktuesit – vlerësime të propozuara nga menaxherët e kontratave, nën mbikëqyrjen e tij.

6. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë pas nënshkrimit.

Me vendim të njoftohen:

- *Menaxheri i kontratës,*
- *Mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë,*
- *Spektori i Prokurimit, dhe*
- *Arkivi.*

